AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi,TM3 2023

10.11.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Inputeve në Bujqësi për tremujorin e tretë (TM3) 2023.

Bie Indeksi i përgjithshëm i Inputeve

Ky publikim është i bazuar në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, farmacitë veterinare, në kompani, tregje dhe vende të tjera, ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Disa çmime të inputeve bujqësore janë marrë nga çmimet e konsumit (IHÇK) në ASK..

Prodhimet, të cilat krijojnë bazë për Indeksin e Çmimeve të inputeve janë të ndara në dy grupe kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2). Brenda grupit Input 1, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbështues, energji, vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinari, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtje e materialeve, mirëmbajtje e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime të tjera. Kurse, sa i përket Input 2, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje të tjera), ndërtesa të tjera (ndërtesat jo-rezidente të fermës, punë të tjera, përveç përmirësimit të tokës).

Indeksi i çmimeve të inputeve TM3 2015 – 2023, (2015 = 100)



Përshkrimi	TM3 2015	TM3 2016	TM3 2017	TM3 2018	TM3 2019	TM3 2020	TM3 2021	TM3 2022	TM3 2023
MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)	102,4	96,0	94,1	93,9	96,1	92,1	109,4	139,9	124,2
MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)	102,8	102,8	103,5	102,4	110,7	111,1	119,8	132,2	137,9
INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)	102,6	99,0	98,3	97,7	102,5	100,5	114,0	136,5	130,3

Rënie e lehtë e Indeksit të Inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) në tremujorin e tretë të vitit 2023, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022

Në tremujorin e tretë të vitit 2023, indeksi i Input 1 ka rënie për (-11.3%), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Kurse, indeksi i Input 2 ka rritje për (4,3%.) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Ndërkaq, Indeksi i përgjithshëm i inputeve (Input 1+Input 2) ka rënie për (-4,5 %), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Përshkrimi	TM3 2022	TM3 2023	Ndryshimi në %
MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)	137,5	123,4	-11,3
MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)	128,6	136,4	4,3
INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)	133,6	129,2	-4,5

Për më shumë informata lidhur me Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi, për TM3 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Agriculture